

**FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:**  
Informacion për pacientin

# FUROSEMID

**Tableta - 40 mg**

**Tretësirë për injekzion - 20 mg / 2 ml  
(Furosemid)**

Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përparrë se të filloni përdorimin e barit.

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është pëershkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjera. Mund t'i dëmtojë atë edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqështet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletëudhëzues:

- Çfarë është Furosemid dhe përsë përdoret
- Përparrë se të merrni Furosemid
- Si ta mermi Furosemid
- Efekte anësore të mundshme
- Si ta ruani Furosemid
- Informacion i mëtejshëm

## 1. ÇFARË ËSHTË FUROSEMID DHE PËRSË PËRDORET

Furosemidi është diuretik me veprim të shpejtë. Ai frenon ripërtithjen e joneve të natriumit dhe të klorit në gjyptat proksimale dhe periferike të ansës Henle dhe si rezultat shtohet ekskretimi i natriumit, klorit dhe ujtit. Po ashtu shtohet edhe ekskretimi urinar i kaliumit, magnezit dhe hidrogenkarbonateve, ndërkohë që pH-i i urinës rritet.

**Furosemid indikohet në:**

- edema që shoqerojnë insuficiencën kardiakë kongjesteive, cirrozën hepatike, sëmundjet e veshkave, përfshirë edhe sindromin nefrotik;
- edema të lokalizuar (pastraumatiqë ose për shkak të djeçive). Furosemid - tretësirë për injekzion indikohet edhe:
  - në edemat pulmonare akute;
  - për mjekimin e oligurisë, për shkak të insuficiencës renale;
  - Furosemidi është i efektshëm në mjekimin e hipertensionit, i vetëm ose i kombinuar me bana të tjera antihipertensive. Furosemidi është i diuretik i fuqishëm, me veprim të shpejtë si dhe është veçanërisht i dobishëm në të sémurët, ku diuretikët e tjera më pak të fuqishëm, sic janë diuretikët tiazidikë, nuk veprojnë sic duhet. Mjeku juaj mund ta ketë dhënen Furosemid për një qëllim tjetër. Pyesni mjekun tuaj në qoftë se doni të dini përsë ju është dhënen Furosemid.

## 2. PËRPARA SE TË MERRNI FUROSEMID

**Mos mermi Furosemid në qoftë se:**

- jeni alergjik ndaj furosemidit ose diuretikëve të tjera, ose ndaj çdo përbërësi tjetër të produkteve Furosemid. Pacientët alergjikë ndaj sulfamidikëve (p.sh. rrjedhësve të sulfanilures, antibiotikëve sulfamidikë) mund të shfaqin ndjeshmëri të kryqëzuar ndaj furosemidit;
  - vuani nga anuria;
  - vuani nga insuficiencia renale për shkak të helmimeve me lëndë nefrotoksite ose hepatotoksite;
  - vuani nga insuficiencia renale, shoqëruar me komë hepatike;
  - jeni në gjendje kome ose pre - kome që shoqerojnë cirrozën hepatike;
  - keni hipokalemji ose hiponatremji të rendë.
- Në qoftë se mendoni se keni ndonjë nga gjendjet e përmendura më sipër, mos e mermi barin. Shkoni dë fllshi fillimi i mësimi me mjekun tuaj dë qëndri këshillat e dhëna.

**Tregoni kujdes të veçantë me Furosemid:**

- Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se:
  - jeni ose keni në plan të ngeleni shtatzënë gjatë kohës që jeni duke përdorur Furosemid;
  - jeni duke marrë diuretikë të tjera apo po mban një dietë me kufizim kaliumi, sepse të sémurët që mjekohen me furosemid duhet të marrin sasi të mjaftueshme kaliumi, nëpërmjet dietës së pasur me kalium (fruta të thata, patate, domate) ose me mjekim (klorur kalium);
  - jeni diabetik gë përdorni insulinë; duhet të ndiqen me kujdes përqëndrimet e glukozës në gjak, sepse nevojat për insulinë mund të ndryshojnë;

- keni hipovolemji dhe hipotension; niveli i elektroliteve duhet të monitorohet gjatë trajtimit me Furosemid;
- keni hipoproteinemi;
- keni gutë;
- vuani nga hipertrofia e prostatales ose çregullime të urinimit.

### Marrja e barnave të tjera

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë së fundmi barna të tjera, edhe ato pa recetë. Furosemid dhe në përgjithësi diuretikët e ansës mund të ndikojnë në efektin e barnave të mëposhtme:

- aminoglikozide (furosemidi mund ta rrisë ototoksicitetin e antibioticëve aminoglikozidikë si gentamicina, kanamicina, neomicina dhe streptomicina, si dhe nefrotoksicitetin e cefaloridinës; antibiotikët aminoglikozidikë dhe furosemidi, sidomos kur ky i fundit merret me rrugë parenteral, nuk duhen përdorur njëherësh);
- hidratat të kloratit;
- glikozideve digitalike (si rezultat i humbjeve të theksuara të kaliumit, në të sémurët që përdorin glikozide digitalike, mund të shfaqet helmueshëm nga këto glikozide);
- karbonatit të litiumit;
- blokuesve neuromuskularë jodepolarizues (furosemidi mund t'i rrisë efektet e tubokurarës dhe të miorelaksuesve të tjere jodepolarizues);
- propranololi;
- sulfanilureikëve;
- teofilinës.

Ndërsa në efektin e furosemidit dhe të diuretikëve të tjera të ansës mund të ndikojnë:

- karboni;
- cisplatinë;
- klofibrati;
- hidantoinat;
- antiinflamatori të josteroidë (p.sh. përdorimi i njëherëshëm i indometacinës dhe i furosemidit mund t'i zgjeloi efektet natriuretike dhe antihipertensive të këtij të fundit);
- probencidil;
- salicilat (mund të shfaqet efekti helmues i salicilateve madje edhe në doza të vogla të furosemidit);
- diuretikët tiazidikë.

Këto bana mund të ndikohen nga Furosemid ose mund të ndikojnë në mënyrën se si ai vepron. Ndaj të përdorimin e njëkohshëm të tyre mund të nevojitet të ulët ose të rritet sasia e furosemidit. Mjeku ose farmacisti juaj do t'ju këshillojë.

### Marrja e Furosemid me ushqim dhe pijë

Ushqimi nuk ndikon në përtithjen e furosemidit. Gjithashtu nuk ka të dhëna që tregojnë se Furosemid ndërvepron me alkoolin.

### Shtatzënia

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni shtatzënë ose po planifikoni të ngeleni shtatzënë. Nuk rekomandohet përdorimi i furosemidit në shtatzëni. Mjeku ose farmacisti juaj do të diskutojë mbi rreziqet dhe përfitimet e marrjes së tij gjatë shtatzënisë.

### Ushqimi me gjji

Njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ushqeni foshnjën me qumësh gjiri sepse nënët që i ushqejnë fëmijët me gjii nuk duhet të përdorin Furosemid.

### Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive

Nuk ka të dhëna që ky bar mund të ndikojë në aftësinë tuaj për të drejtuar automjetin ose të ndikojë në punën tuaj me makineri.

### Informacione të rëndësishme mbi disa nga përbërësit e Furosemid

#### Për tabletën

Ky bar përbën laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përparsë se të mermi këtë bar.

### 3. SI TA MERRNI FUROSEMID

Gjithmonë mermi tabletat Furosemid vetëm sipas këshillës së mjekut. Në qoftë se ndjeni që efektet e Furosemid janë shumë të fortë ose shumë të dobëta, flisni me mjekun ose farmacistin tuaj.

### Furosemid - tableta 40 mg:

#### Nga goja

Në edemat: në fillim përdoren 40 mg në mëngjes; doza mbajtëse është 20 mg në ditë ose 40 mg, një ditë po, një ditë jo; në edemat

rezistente doza mund të rritet në 80 mg në ditë. Fëmijët: 1 - 3 mg / kg peshë në ditë, maksimumi 40 mg në ditë. Në hipertension: merrën 40 - 80 mg në ditë, vetëm ose bashkë me antihipertensivë të tjera. Në oliguri: në fillim përdoren 250 mg në ditë; në qoftë se është e nevojshme mund të përdoren doza më të larta, që vijnë duke u rritur shkallë - shkallë 250 mg, çdo 4 - 6 orë, deri në një dozë maksimale njëherëshe 2 g (përdoret rrallë). Këshillohet që tabletat të merren në të njëjtën orë që do të ditë. Tabletat e Furosemid duhet të gjelliten të plota me një gotë ujë.

### Furosemid - tretësirë për injekzion 20 mg / 2 ml:

Me injektim në muskul ose me injektim të ngadalshëm në venë (me një shpejtësi që nuk kalon 4 mg / minutë): në fillim përdoren 20 - 50 mg. Fëmijët: 0.5 - 1.5 mg / kg peshë, deri në një dozë maksimale ditore prej 20 mg.

### Me perfuzionim në venë:

Në oliguri: në fillim përdoren 250 mg për 1 orë (shpejtësia nuk duhet të kalojë 4 mg / minutë); në qoftë se nuk arritet jashtëqitje e kënaqshme e urinës në orën që vijnë, mund të përdoren 500 mg për 2 orë e pastaj nëse urinimi nuk është i kënaqshëm në orën që vijnë, mund të përdoret 1000 mg për 4 orë, dhe në qoftë se nuk arritet rezultati i duhur mund të lindë nevoja për dializë. Doza efektive (deri 1000 mg) mund të përsëritet çdo 24 orë.

Mjeku juaj mund t'ju kërkojë të mermi Furosemid për një kohë më të gjatë. Pyesni mjekun tuaj për këshillë në qoftë se nuk jeni të sigurt për sa kohë duhet ta mermi.

### Në qoftë se keni marrë më shumë Furosemid:

Në qoftë se keni marrë më shumë Furosemid se sasia që duhet të mermi, ose në qoftë se fëmijët e kanë marrë gabimisht këtë bar, ju lutemi të kontaktoni mjekun tuaj, spitalin ose të telefononi urgjencën për të marrë një mendim për rrezikun dhe këshillë për veprimet që duhet të ndërmerren.

### Në qoftë se keni harruar të mermi Furosemid:

Në qoftë se harroni një dozë, mermi dozën në vazhdim kur të jetë koha përmarrje e zakonshme të saj. Mos mermi një dozë të fishtë për të plotësuar dozën e harruar. Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Të gjitha barnat mund të shkaktojnë efekte anësore. Ndonjëherë ato janë serioze, shumicën e herëve jo. Mos u alarmoni nga kjo listë e efekteve të mundshme anësore. Mund të mos ju shfaqet asnjë prej tyre.

Njoftoni mjekun tuaj në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore të mëposhtme ju shqetëson:

- çregullimi i bilancit të lëngjeve dhe elektrolitëve, sidomos kur përdoren doza të larta, ose kur mjekimi vazhdon për kohë të gjatë. Diureza e theksuar mund të shaktojë dehidrim dhe ulje të vëllimit të gjakut, me çregullime të qarkullimit, sidomos në të sémurët e moshuar;
- hiponatremji, alkalozë hipokalemike dhe hipokalemike;
- çregullime gastrointestinale (të përziera, diarreë);
- alerji;
- ekzantema;
- ndryshime në elementet e gjakut (trombocitopeni, agranulocitozë, leukopeni, anemi aplastike);
- zurmë në vesh dhe humbie të përkohshme të dégjimit, sidomos gjatë përdorimit të dozave të larta të marra në rrugë parenteralë dhe në të sémurët me démitë të funksionit të veshkave;
- hiperuricemi, glukozuri dhe hiperglicemi;
- ulje të nivelit të kalciumit në gjak (janë pëershkuar raste të rralla të tetanisë).

Efekte të tjera të padëshirueshme, relativisht mjartë rralla, janë:

- turbullimi i të parit, marrje mendsh, dhimbje koke, pankreatit, fotosensibilitet, spazma muskulore, hipotension postural dhe që mund të rëndohen nga alkooli dhe narkotikët;
  - parestezi dhe démtëtë të mëlçisë.
- Kur efektet anësore janë mesatare ose të rënda doza e Furosemid duhet ulur ose mjekimi duhet ndërrprerë. Në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk janë të përmendura në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

### 5. SI TA RUANI FUROSEMID

Mbajeni larg fëmijëve.

Mos e përdorni Furosemid pas datës së skadimit e cilësështë e shënuar në paketim.

Mos e ruani mbi 25°C.

### 6. INFORMACION I MËTEJSHËM.

#### Çfarë përmban Furosemid - tableta 40 mg:

Lëndë vepruese është furosemid.

Çdo tablete përmban 40 mg furosemid.

Përbërës të tjera janë: amidon misri, laktozë, kroskarmelozë natrumi, PVP K30, stearat magnezi, talk, glikolat natrumi i amidonit.

#### Çfarë përmban Furosemid - tretësirë për injekzion 20 mg / 2 ml:

Lëndë vepruese është furosemid.

Çdo ampulë 2 ml përmban 20 mg furosemid (1%).

Përbërës të tjera janë: hidroksozid natrumi, klorur natrumi dhe ujë përinjekcion.

#### Përbajtja e paketimit:

##### Furosemid - tableta 40 mg:

- kuti me 10 tableta

- kuti me 30 tableta

##### Furosemid - tretësirë për injekzion 20 mg / 2 ml:

- kuti me 10 ampula;

- kuti me 100 ampula (përdorim spitalor).

### Shpjegues i ikonave ilustruese në paketim:

Këshillohuni me mjekun ose farmacistin tuaj.

Përbajtja. Kujdes.

Forma e tabletës.

Tretësirë për injekzion - Ampula

### Mbajtësi i autorizimit për tregtim (MAT) dhe prodhuesi:

PROFARMA Sh.a.  
Rruga "Myslym Keta"  
Tel.: 00355 4 23 89 602  
Tiranë - Shqipëri

Ky fletëudhëzues u formuloa për herë të fundit në Maj 2015.